

DOKUMENT POLITIKASH

STATUSI I NDËRMARRJES SOCIALE

PIKËPYETJET
DHE
MUNDËSITË PËR NDRYSHIM

2022



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Përgatitur nga:

Era Sherifaj

Grafika dhe faqosja:

Maris Selamaj

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Tiranë, Shqipëri 2022

"Ky dokument politikash është realizuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim me mbështetjen e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS) në kuadrin e projektit "RISE-ALB: Rafforzamento dell'Imprenditorialità Sociale in Albania" (AID 011864) i zbatuar nga ENGIM Internazionale.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Agjencisë Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim. As institucionet, as organet e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor, dhe as ndonjë person që vepron në emër të tyre, nuk mund të mbahen përgjegjës për asnjë përdorim të informacionit që përmban ky dokument politikash."

STATUSI I NDËRMARRJES SOCIALE

PIKËPYETJET
DHE
MUNDËSITË PËR NDRYSHIM

ABSTRAKT

Sipërmarrja sociale luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të shoqërisë, duke ofruar mundësi për integrimin dhe përmirësimin e jetesës së komunitetit. Në Shqipëri, rëndësia e sipërmarrjeve sociale është kuptuar që herët pasi format e para të sipërmarrjes sociale e kanë filluar aktivitetin e tyre para viteve 2000, si pjesë e aktiviteteve të projekteve dhe programeve jofitimprurëse të mbështetura nga donatorë të huaj. Në aspektin ligjor, sipërmarrjet sociale në Shqipëri filluan të rregullohen dhe të njihen si të tilla në vitin 2016, me miratimin e ligjit nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilat u pasuan nga thirrja për marrjen e statusit të Ndërmarrjes Sociale (NS) dhe thirrja për financim nga Fondi i Ndërmarrjeve Sociale.

Ky dokument politikash synon që nëpërmjet analizës së procesit të aplikimit për statusin e NS-së dhe të aplikimit për mbështetje financiare nga Fondi i Ndërmarrjeve Sociale (FNS), të ofrojë rekomandime që adresojnë sfidat dhe vështirësitë e hasura nga Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF) që kanë marrë pjesë në proces, si dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si institucion përgjegjës për menaxhimin e këtij procesi.

Për përgatitjen e dokumentit u shfrytëzua dhe analizua dokumentacioni i kuadrit ligjor, informacioni i siguruar nëpërmjet kërkesave zyrtare për informacion, pyetësorët më OJF-të që kanë aplikuar/janë në proces aplikimi/ u është refuzuar statusi i NS, takimet konsultuese me OJF-të dhe tryezat ndërinstitucionale të organizuara me OJF-të, MSHMS-në dhe aktorë të tjerë të ekosistemit të NS-ve.

"NË SHQIPËRI, RËNDËSIA E SIPËRMARRJEVE SOCIALE ËSHTË KUPTUAR QË HERËT PASI FORMAT E PARA TË SIPËRMARRJES SOCIALE E KANË FILLUAR AKTIVITETIN E TYRE PARA VITEVE 2000"



Rezultatet tregojnë se ligji paraqet disa problematika të cilat krijojnë hapësira për interpretime të ndryshme në zbatimin e tij, paqartësi në lidhje me dokumentacionin që duhet dorëzuar dhe procedurat që duhen ndjekur për aplikimin për status dhe për financim nga FNS. Këto problematika kanë vështirësuar dhe zgjatur procesin e aplikimit për statusin dhe në rastin e aplikimit për financim kanë ndikuar në përmbylljen në mënyrë jo të suksesshme të procesit.

Ky dokument politikash përmbledh dhe prezanton tek institucionet shtetërore përgjegjëse, ndërmarrjet sociale, OJF-të që dëshirojnë të marrin statusin e NS, donatorët që mbështesin zhvillimin e sipërmarrjeve sociale në vend dhe aktorë të tjerë të interesuar, çështje kryesore që paraqesin barriera për aktivitetin e ndërmarrjeve sociale, të cilat duhet të sillen në vëmendje dhe duhen adresuar për të lehtësuar mirëfunksionimin e tyre. Në këtë mënyrë, dokumenti kontribuon në zhvillimin e sektorit të sipërmarrjes sociale dhe rrjedhimisht në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë sociale dhe ekonomike të vendit.

TABELA E PËRMBAJTJES

4	ABSTRAKT
8	ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR MBI NDËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI
9	METODOLOGJIA
11	APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE
12	ANALIZË E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR MARRJEN E STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE
18	KOHËZGJATJA E APLIKIMIT PËR MARRJEN E STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE
19	FONDI NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE
24	DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR FINANCIM PËR NDËRMARRJET SOCIALE
26	ANALIZË E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM PËR FINANCIM
29	APLIKIMI I FONDIT NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE NGA PËR PERIUdhËN 2019-2021.
30	REKOMANDIME
34	SHTOJCA 1. AKTET NËNLIGJORE NË FUNKSION TË LIGJIT NR. 65/2016 “PËR NDËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI”.



ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR MBI NDËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI

Në vitin 2016 në Shqipëri është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale si dhe përcakton kushtet dhe kriteret për përfitimin dhe mbajtjen e statusit të NS-së. Ky ligj u aprovua pavarësisht problematikave të shumta që ai mbarte, të identifikuar, prezantuar dhe diskutuar nga aktorët e ekosistemit me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale. Një analizë e plotë e ligjit është realizuar nga Partnerët Shqipëri në vitin 2019.[1]

Pas miratimit të tij, për një periudhë 4 vjeçare deri në vitin 2020, ligji u plotësua me aktet nënligjore përkatëse, të cilat duhet të ishin nxjerrë nga institucionet përgjegjëse brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit[2]. Pavarësisht përcaktimeve kohore, kjo paketë ligjore vazhdon të mos jetë e plotësuar pasi mungon udhëzimi për “Procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për ndalimin e veprimtarisë së një ndërmarrje sociale dhe heqja e statusit të NS”[3]. Kjo vonesë në nxjerrjen e akteve nënligjore, rezultoi në mosvënien në zbatim të ligjit deri në vitin 2019 (tre vite pas aprovimit të ligjit). Listën e akteve nënligjore të nxjerra deri më tani në funksion të ligjit nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” e gjeni të plotë në Shtojcën Nr.1.

Në maj të vitit 2019, MSHMS nxori për herë të parë udhëzimin dhe thirrjen për aplikim për regjistrim dhe marrjen e statusit të NS[4]. Thirrja qëndron e hapur dhe organizatat e interesuara mund të aplikojnë në çdo kohë për marrjen e statusit të NS. Nga informacioni i përditësuar nga MSHMS rezulton se deri në muajin prill të vitit 2022, vetëm 13 OJF kanë aplikuar për përfitimin e statusit të NS, nga të cilat 9 OJF që operojnë në qytetin e Shkodrës, Kukësit, Tiranës dhe Beratit kanë marrë statusin e NS-së, ndërsa 4 OJF-ve të tjera u është refuzuar statusi.

Në shkurt të vitit 2020, MSHMS shpalli thirrjen për aplikime për financim nga Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale[5], për subjektet që kanë marrë statusin e NS-së. Sipas informacionit nga MSHMS, 4 NS (nga 8 OJF me statusin e NS në atë periudhë kohore) kanë aplikuar për financim nga Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale. Në përfundim të procesit, asnjë aplikim nuk u përzgjedh për financim nga Fondi i dedikuar për periudhën 2019-2021[6].

[1] <http://partnersalbania.org/publication/analize-e-kuadrit-ligjor-mbi-ndermarrjet-sociale-ne-shqiperi/>

[2] Ligji Nr. 65/2016, “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, pika 1 dhe 2

[3] Ligji Nr. 65/2016, “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, pika 2

[4] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[5] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[6] Sipas informacionit të siguruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet kërkesës zyrtare për informacion



METODOLOGJIA

Ky dokument është përgatitur përmes analizës së paketës ligjore, informacionit të grumbulluar në formë të standardizuar nëpërmjet pyetësorëve drejtuar OJF-ve të cilat janë në proces aplikimi për statusin, kanë marrë statusin, ose u është refuzuar statusi i NS, takime me OJF-të, informacionit të dhënë nga MSHMS përmes kërkesave zyrtare për informacion dhe takimeve. Si dhe nëpërmjet një tryeze ndërinstucionale me përfaqësues nga MSHMS, OJF dhe aktorë të ndryshëm të ekosistemit të NS, për të diskutuar dhe hulumtuar më tej çështjet e identifikuara nga të dhënat e mësipërme.

STATUSI I NDËRMARRJES SOCIALE



9 OJF KANË MARRË STATUSIN E NDËRMARRJES SOCIALE

Pas miratimit të ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore, në shkurt të vitit 2019, MSHMS shpalli thirrjen për aplikim për regjistrim dhe për marrjen e statusit të NS. Në këtë pjesë të dokumentit bëhet një prezantim i kushteve që duhen të plotësohen dhe dokumentacionit që duhet të dorëzohet nga OJF-të gjatë aplikimit për marrjen e statusit dhe një analizë që identifikon sfidat dhe barrierat e hasura nga OJF-të dhe MSHMS gjatë procesit.



APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E STATUSIT

Kushtet, hapat dhe procedurat që duhen ndjekur për aplikim dhe marrjen e statusit të NS-së bazuar në udhëzimin Nr.602, datë 01.08.2018 “Për Procedurat dhe Dokumentacionin e Nevojshëm Për Marrjen e Statusit të Ndërmarrjes Sociale”[7] dhe udhëzuesit të MSHMS “Thirrje për Aplikim dhe Marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale” 2019 [8], janë:



✓ FORMA JURIDIKE E ORGANIZATËS AKTUALE

Subjekti duhet të jetë i regjistruar si Organizatë Jo Fitimprurëse.

✓ KËRKESË DREJTUAR MSHMS

Fillimi i procedurës nga vetë OJF me anë të një kërkesë me shkrim nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar, drejtuar MSHMS sipas formatit të aplikimit[9] të miratuar nga kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.

✓ KRITERET SOCIALE

-Ndërmarrja sociale synon nxitjen e objektivave socialë në një fushë veprimtarie të mirë përcaktuar.
-Të paktën 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pa favorizuara nga programi i Mbrojtjes Sociale nga pikëpamja sociale dhe ekonomike.

✓ KRITERET EKONOMIKE

-Ushtrimi në mënyrë të vazhdueshme i një veprimtarie në fushën e prodhimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve;
-Të paktën 20 për qind e të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit dhe, të paktën 30 për qind e të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, duhet të realizohen nga veprimtaritë e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
-Përfshirja në veprimtarinë e NS e të paktën 3 punonjësve me pagesë, përveç kontributit të vullnetarëve;
-Përdorimi i të ardhurave të realizuara nga veprimtaria ekonomike e ndërmarrjeve për zgjerimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

✓ DOKUMENTACIONI BAZË

-Një vërtetim të lëshuar, jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit, nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
-Një kopje të statutit dhe aktit të themelimit;
-Një vendim të organit më të lartë vendimmarrës të organizatës jofitimprurëse ku të shprehet qëllimi i organizatës për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale;
-Dokumente të tjera që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve ekonomike e sociale;
-Kopje të licencës, nëse do të jetë rasti;
-Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti.
-Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose kur vlerësohet e arsyeshme, strukturat përkatëse mund të kërkojnë dokumentacion shtesë përveç atij të paraqitur nga kërkuesi.

[7] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/121/459ff5dd-cd3e-4f2d-85b1-914f93e9fd6f;q=Udh%C3%ABzim%20Nr.%20602,%20dat%C3%AB%201.8.2018%20>

[8] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[9] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

ANALIZË E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR MARRJEN E **STATUSIT**

LIGJI NR. 65/2016 “PËR NDËRMARRJET SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE UDHËZUESI “THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM DHE MARRJEN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE”

Në zbatim të ligjit, gjatë procesit të aplikimit janë hasur disa problematika që kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit. Nga analizimi i gjithë elementeve të procesit, rezulton së burimi kryesor prej nga rrjedhin shumica e problematikave është vetë Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Kuti 1 : Neni 1, Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”

NENI 1

OBJEKTI

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale dhe përcakton kushtet e kriteret që një subjekt duhet të plotësojë që të përfitojë statusin e ndërmarrjes sociale.

KREU II KRITERET

NENI 7

KRITERET

Një subjekt **për të mbajtur** statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësojë një minimum kriteresh të natyrës ekonomike dhe sociale.

NENI 8

KRITERET EKONOMIKE

Për të mbajtur statusin e **ndërmarrjes sociale** duhet të plotësohen këto kriterë ekonomike:

1. **Ndërmarrja sociale** duhet të ushtrojë në mënyrë të vazhdueshme një veprimtari në fushën e prodhimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve.
2. Të paktën, 20 për qind e të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit dhe, të paktën, 30 për qind e të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, duhet të realizohen nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.
3. Në veprimtarinë e saj **ndërmarrja sociale**, përveç kontributit të vullnetarëve, duhet të përfshijë domosdoshmërisht edhe, **të paktën, 3 punonjës me pagesë**.
4. Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike e **ndërmarrjeve sociale** i shërbejnë zgjerimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

NENI 9

KRITERET SOCIALE

Për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësohen këto kritere sociale:

1. **Ndërmarrja sociale** synon nxitjen e objektivave sociale në një fushë veprimtarie të mirë përcaktuar.
2. Të paktën, 30 për qind e punonjësve të punësuar në **ndërmarrjen sociale** duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pa favorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

Ashtu si vihet re edhe nga nenet më sipër, ligji nuk shprehet lidhur me kriteret që duhet të përmbushë një OJF për të përfituar statusin e ndërmarrjes sociale. Në nenin 1 përcaktohet objekti i ligjit, i cili ndër të tjera, përcakton kushtet dhe kriteret për të përfituar statusin e NS, por në asnjë nga nenet e ligjit nuk jepen këto kritere, ndërkohë që në nenin 7 të

ligjit përcaktohen kriteret e nevojshme për të mbajtur statusin e NS, të cilat paraqiten në nenin 8 dhe nenin 9 të ligjit.

Kjo mangësi e ligjit, është adresuar me udhëzimin e nxjerrë nga MSHMS për aplikim për marrjen e statusit, e cila me rregullim të brendshëm e ka interpretuar ligjin si më poshtë:

Kuti 4: Udhëzues, "Thirrje për Aplikim për Regjistrim dhe Marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale[10]" MSHMS, 2019

KUSH MUND TË APLIKOJË

Vetëm organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të aplikojnë për të marrë statusin "ndërmarrje sociale", **që duhet të plotësojnë një minimum kriteresh ekonomike dhe sociale** të përcaktuara nga ligji, Nr. 65/20 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", **për të përfituar dhe mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale.**

Shënim: Kriteret sociale dhe ekonomike të përcaktuara në udhëzim nga MSHMS janë të njëjtat me ato të specifikuar në ligj si më sipër.

[10] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

Siç shihet, në interpretimin e saj të ligjit, MSHMS në mungesë të përcaktimeve të kriterëve nga ligji, ka vendosur që kriteret ekonomike dhe sociale të përcaktuara për të mbajtur statusin, të aplikohen edhe për të përfituar statusin.

Ky interpretim i ministrisë sjell disa problematika, si më poshtë:

Sa pari, duke qenë se kriteret për të përfituar statusin janë kopje e kriterëve të përcaktuara nga ligji për të mbajtur statusin, ka problematika në terminologjinë e përdorur në udhëzuesin "Thirrje për Aplikim për Regjistrim dhe Marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale". Termi i përdorur në udhëzues "ndërmarrjet sociale" në këtë rast nuk është korrekt, pasi organizatat janë në proces aplikimi dhe nuk e kanë përfituar ende statusin e NS.

Së dyti, këto kritere nuk mund të jenë të aplikueshme për një organizatë që është në fazat e para të aktivitetit të sipërmarrjes sociale dhe nuk ka pasur aktivitet ekonomik për më shumë se një vit apo dy vjet. Për të adresuar këtë problematikë, MSHMS në kundërshtim me këtë përcaktim të udhëzuesit, ka pranuar që organizatat e reja të mos dorëzojnë dokumentacion që verifikon se të paktën 20% të ardhurave pas vitit të dytë dhe 30% e të ardhurave pas vitit të tretë të jetë realizuar nga veprimtaritë e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave[11]. Ky "lehtësim" për organizatat e reja, bie ndesh me parimet e barazisë që duhet të udhëheqin një proces aplikimi, pasi penalizon organizatat të cilat kanë pasur aktivitet ekonomik për periudhën që parashikon udhëzuesi, por nuk kanë arritur të plotësojnë nivelin e përcaktuar të të ardhurave që duhet të vijë nga veprimtaria ekonomike.

Në një perspektivë tjetër, dorëzimi i dokumentacionit që verifikon të ardhurat e veprimtarisë ekonomike, nuk ka vlerë nëse në momentin e aplikimit për status, organizatat që kanë pasur një aktivitet ekonomik vendosin ta diversifikojnë veprimtarinë, ose ta ndryshojnë atë për t'iu përshtatur veprimtarive të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Së treti, një problematikë që vjen nga interpretimi i ligjit, është ngushtimi i qëllimit të tij, duke e vendosur atë totalisht në funksion të zbatimit të politikave të punësimit. Siç përcaktohet në nenin 2 të ligjit, qëllimi i tij është mbrojtja dhe përfshirja sociale e grupeve vulnerabël, ndërkohë që punësimi dhe ofrimi i mundësive për punësim shikohen si mënyra për arritjen e tij. Ky orientim është reflektuar edhe në dokumentacionin e kërkuar nga MSHMS gjatë procesit të aplikimit. Përveç vendimit që vërteton përkatësinë e punonjësve në një prej kategorive të grupeve të pa favorizuara të përcaktuara në Vendimin Nr. 56, datë 31.01.2018 "Për Përcaktimin e Kategorive Konkrete të Grupeve të Pa favorizuara"[12], MSHMS kërkon për çdo rast, pavarësisht grupit të pa favorizuar që i përket, vërtetimin e papunësisë të lëshuar nga Zyra e Punës. Kjo kërkesë, e cila nuk është e shprehur në asnjë dokument, i heq të drejtën personave nga grupe të pa favorizuar të punësuar në kushte jo të favorshme, për një mundësi punësimi në përputhje me dinjitetin njerëzor, siç përcaktohet në qëllimin e ligjit.

[11] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/3/02fe6caf-962b-45b4-b467-b9683e2b6d84;q=VENDIM%20Nr.%2016,%20dat%C3%AB%2012.1.2018%20>

[12] <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/03/VKM-nr.-56-date-31.1.2018.pdf>

NENI 2

QËLLIMI

Ky ligj ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, nëpërmjet:

- a) punësimit, në kuadër të njohjes së të drejtës themelore të individit për të pasur burime të mjaftueshme jetese, në përputhje me dinjitetin njerëzor;
- b) ofrimit të mundësive të punësimit për personat, të cilëve moshë, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës;
- c) ofrimit të mallrave dhe shërbimeve në forma të larmishme dhe me cilësi të mirë, duke siguruar mundësi të përshtatshme dhe të arritshme për individët me nevoja të veçanta, si dhe duke shënuar një hap thelbësor drejt barazisë gjinore, pasi këto shërbime lehtësojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës;
- ç) integritit ekonomik e social të grupeve në nevojë, duke nxitur frymën e përgjegjshmërisë, solidaritetit dhe kohezionit shoqëror në komunitet.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MARRJEN E STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE



Sipas organizatave që iu përgjigjën pyetësorit lidhur me aplikimin për marrjen e statusit të NS-së, informacioni dhe dokumentacioni ligjor (ligji, udhëzime, rregullore, forma të aplikimit) i nevojshëm për plotësimin e aplikimit, ka qenë i lehtë për t'u siguruar, dhe MSHMS ka orientuar dhe ndihmuar organizatat në sigurimin e informacionit të duhur. Formulari i aplikimit për statusin e NS, është i kuptueshëm dhe plotësimit i tij ka qenë relativisht i lehtë. Në përgjithësi, gjatë procesit të aplikimit OJF-të janë asistuar nga MSHMS.

Vështirësia kryesore e cila identifikohet si nga organizatat që kanë aplikuar për marrjen e statusit, ashtu edhe nga MSHMS, qëndron në dorëzimin e dokumentit që provon përkatësinë e punonjësve në një prej kategorive të grupeve të pa favorizuara. Pothuajse të gjitha organizatat që kanë aplikuar për marrjen e statusit, kanë hasur probleme me sigurimin e dokumentacionit për punonjësit që u përkasin grupeve të pa favorizuara, e cila ka rezultuar në zgjatjen e procesit dhe shtimin e kostove të organizatës.


Dy janë problematikat kryesore lidhur me këtë dokumentacion:

1. Në Vendimin Nr. 56 datë 31.01.2018 "Për Përcaktimin e Kategorive Konkrete të Grupeve të Pafavorizuara", apo në vendime dhe udhëzime të tjera që lidhen me të, nuk është e përcaktuar lloji dhe forma e dokumentit që vërteton përkatësinë e punonjësit në një prej këtyre kategorive. Lista e kategorive të grupeve të pa favorizuara në këtë vendim rendit 28 kategori të ndryshme, për disa prej të cilave rezultoi pamundur marrja e një dokumenti nga një institucion përgjegjës për lëshimin e tij. P.sh. pika k) gratë dhe vajzat viktime / viktima të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje, pika s) personat me identitet të ndryshëm gjinor dhe orientim të ndryshëm seksual, apo pika j) gratë që jetojnë në zonat rurale: i) ku niveli mesatar i papunësisë e kalon 50% të nivelit mesatar kombëtar për të paktën dy vjet kalendarikë; ii) ku papunësia e gjinisë femërore është mbi 150% e nivelit mesatar të papunësisë së gjinisë mashkullore për të paktën dy nga tre vjetët e fundit kalendarikë. Në rastin e fundit (pika j), përveç pamundësisë së marrjes së një dokumenti provues, nuk është e qartë nëse duhet të plotësohet vetëm njëri prej kushteve apo të dy njëkohësisht.
2. Siç u përmend më sipër, bazuar në kërkesat e ministrisë çdo aplikant duhet të dorëzojë si pjesë e dokumentacionit, vërtetimin e papunësisë për punonjësin/t nga grupet e pa favorizuara, të lëshuar nga Zyra e Punës si institucion regjistruar i punëkërkuarve dhe lëshues i vërtetimeve të papunësisë, përveç dokumentit që provon përkatësinë në një grup tjetër (nëse është e aplikueshme).

Kjo kërkesë nga ana e MSHMS, nuk shprehet në asnjë prej vendimeve që lidhen me aplikimin për marrjen e statusit, dhe duket se bie në kundërshtim me vet Vendimin Nr. 56 datë 31.01.2018, në të cilin, të papunët për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh, listohen si një ndër kategoritë e grupeve të pa favorizuara (pika d). Në ndryshim nga vërtetimi i papunësisë për këtë kategori (pika d), për gjithë kategoritë e tjera nuk është e rëndësishme periudha e papunësisë. Kjo kërkesë e ministrisë, përveç se shton detyrimin e OJF-ve për dorëzimin e dokumenteve shtesë, e parë në një këndvështrim tjetër, e bën të pavlefshëm dhe të panevojshëm dorëzimin e dokumentit që provon përkatësinë në një grup tjetër të pa favorizuar (p.sh. personat me aftësi të kufizuar), në rast se ky individ rezultoi i papunë për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh.

KOHËZGJATJA E APLIKIMIT PËR MARRJEN E STATUSIT

KOHËZGJATJA E PROCESIT PËR APLIKIM DHE NJOFTIMI PËR STATUSIN E NS



Në udhëzuesin e thirrjes për aplikim për regjistrim dhe për marrjen e statusit të NS[13] specifikohet se kërkuesit njoftohen për vendimin e njohjes apo refuzimit të statusit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës dhe në rast të refuzimit të statusit, njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyet e refuzimit. Ndërkohë që sipas MSHMS[14] afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave janë respektuar, për shkak të problematikave të identifikuara më sipër, kohëzgjatja e këtij procesi ka qenë mesatarisht 5-6 muaj, me kohëzgjatjen më të lartë 8 muaj, dhe ka qenë i shoqëruar me komunikime të vazhdueshme midis OJF-ve dhe ministrisë për dorëzimin e dokumentacionit, sipas kërkesave të ministrisë.

REGJISTRI I NDERMARRJEVE SOCIALE



Në udhëzimin për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve sociale[15] por edhe në ligj[16] është vendosur se ndërmarrjet sociale pas përfitimit të statusit do të regjistrohen në regjistrin e ndërmarrjeve sociale, i cili do të jetë publik. Sipas MSHMS, regjistri i ndërmarrjeve sociale është i dokumentuar në formatin e një tabele në Exel, por nuk është krijuar ende në një format elektronik të aksesueshëm për publikun.

[13] Udhëzues, MSHMS, datë 06/05/2019 "Thirrje për Aplikim për Regjistrim dhe Marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale"

<https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[14] Tryeza ndër-institucionale

[15] Udhëzim Nr.22, datë 04.01.2019 "Për Krijimin e Regjistrit të Ndërmarrjeve Sociale dhe Rregullat për Mbajtjen e Tij"

[16] Ligji Nr.65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 15,pika 3

FONDI NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE



Mbështetur në VKM Nr.85, datë 25.6.2018 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore për Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve Sociale[17]” dhe VKM Nr.789, datë 26.12.2018 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale”[18], u krijua fondi në mbështetje të ndërmarrjeve sociale për periudhën 2019-2021 me vlerë të përgjithshme 249 760 000 (dyqind e dyzet e nëntë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Në vijim krijimi i fondit u shoqërua me Udhëzimin Nr.376, datë 18.06.2020 “Për Kriteret e Dhënies dhe Mekanizmin e Monitorimit të Ndihmës

Shtetërore të Ndërmarrjes Sociale[19]” dhe Udhëzuesin “Thirrje Për Aplikime për Financimin e Subjekteve që kanë Marrë Statusin e Ndërmarrjeve Sociale”[20].

Nga analiza e akteve nënligjore, udhëzimeve në lidhje me Fondin e Ndërmarrjeve Sociale vihet re se informacioni i paraqitur në këto dokumente shpeshherë është i paqartë dhe jo i plotë, e cila mund të çojë në konfuzion dhe keqinterpretim të tyre.

[17] <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/06/25/85>

[18] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/192/fd987916-e4d4-4cb6-8f4c-1cacc488f742;q=%E2%80%93%20VENDIM%20Nr.%20789,%20dat%C3%AB%2026.12.2018%20>

[19] <http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/06/18/376>

[20] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

Si më poshtë, disa nga informacionet prezencë e të cilave me shpjegim të ndryshëm dhe në pjesë të ndryshme të këtyre dokumenteve, shkaktojnë konfuzion:

- Në pikën 2 të VKM Nr.85, datë 25.6.2018 “Autorizim i Ndhmës Shtetërore për Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve Sociale” përcaktohet se ndihma do të jepet në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit por nuk është përcaktuar se cilat janë këto forma të subvencionit.
- Në pikën 2 dhe 3 të VKM-së ka informacion në lidhje me limitin maksimal të vlerës që subjektet mund të përfitojnë nga fondi, kostot e pranueshme sipas skemës së propozuar në projektvendim dhe përqindjen e kostove që mund të mbulohet nëpërmjet

ndihmës. Sipas skemës së propozuar në projektvendimin e MSHMS “Për Krijimin e Fondit të Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale” ky informacion lidhet drejtpërdrejt vetëm me një prej formave të subvencionit: për veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale.

Kuti 6: Pika 2,3,4 VKM Nr.85, datë 25.6.2018 “Autorizim i Ndhmës Shtetërore për Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve Sociale”

2. Ndhimja do të jepet në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit, me vlerë të përgjithshme prej 249,760,000 lekësh dhe skema do të ketë një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tri) vitesh, për periudhën 2019–2021.

3. Ndhimja do të mbulojë 70% të kostove të pranueshme dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, por jo më shumë se 1,500,000 lekë, në rast se subjekti është në gjendje të financojë pjesën e mbetur të investimit.

4. **Skema e propozuar në projektvendim**, lejon si kosto të pranueshme:

- a) Investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit;
- b) Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara;
- c) Mbulimin deri në 50% të pagës minimale për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara për një periudhë 6-mujore.

Me miratimin e VKM Nr.789, datë 26.12.2018 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale”, përcaktohet se ndihma do të jepej në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit për të subvencionuar:

- Veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale nëpërmjet fondit me vlerë 135 000 000 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë) lekë (e cila përfshin të gjitha kostot e pranueshme të përcaktuara në VKM Nr.85);
- Vendet e reja të punës të krijuara për punësimin e individëve nga grupet e pafavorizuara, nëpërmjet fondit me vlerë 37 000 000 (tridhjetë e shtatë milionë) lekë;

- Sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pa favorizuara, nëpërmjet fondit me vlerë 7 776 000 (shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

Për secilën prej formave, vendimi përcakton edhe: kushtet që duhet të plotësohen nga NS për përfitimin e subvencionit, kosto e pranuar dhe niveli i pagesës nga fondi, si më poshtë:

1. SUBVENCION PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJEVE SOCIALE

1.1 KUSHTET QË DUHEN TË PLOTËSOHEN

1.1.1 Subjektit t'i jetë njohur statusi i ndërmarrjes sociale me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

1.1.2 Të ketë një plan biznesi ose një projekt dhe të jetë e aftë për zbatimin e plotë dhe në kohë të veprimtarive/aktiviteteve të propozuara;

1.1.3 Të punësojë minimalisht 3 (tre) punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë në ndërmarrjen sociale.

1.2 KOSTOT E PRANUARA

FONDI MBULON DERI NË 70% TË KOSTOVE TË PRANUARA, POR JO MË SHUMË SE 1 500 000 (NJË MILION E PESËQIND MIJË) LEKË, NË RAST SE SUBJEKTI ËSHTË NË GJENDJE TË FINANCOJË PJESËN E MBETUR TË INVESTIMIT

1.2.1 për investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit;

1.2.2 për kualifikimin dhe trajnimin për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara;

1.2.3 për mbulimin, deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës minimale, për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara, për një periudhë gjashtëmuajore

1.3 PAGESA

1.3.1 Pagesa e subvencionit të përfituar për zhvillimin e veprimtarisë bëhet 70% (shtatëdhjetë për qind) me miratimin e aplikimit por jo më shumë se 1.050.000 lekë dhe 30% (tridhjetë për qind) në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave, e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera. Dokumentet e përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimeve (investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit) është fatura e thjeshtë tatimore me TVSH. Për të gjitha mallrat e blera do hartohet dokument hyrje dhe për çdo proces të realizuar do hartohet dokument dalje.

1.3.2 Një ndërmarrje sociale, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së saj, përfiton vetëm një herë subvencionin për zhvillimin e veprimtarisë.

2. SUBVENCION PËR VENDET E REJA TË PUNËS TË KRIJUARA PËR PUNËSIMIN E INDIVIDËVE NGA GRUPET E PA FAVORIZUARA

2.1 KUSHTET QË DUHEN TË PLOTËSOHEN

2.1.1 Punësimin e personave nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara dhe kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se dy vjet

2.2 KOSTOT E PRANUARA

NDËRMARRJET MUND TË PËRFITOJNË DERI NË 100 000 (NJËQIND MIJË) LEKË, PËR ÇDO VEND TË RI PUNE

2.2.1 mjete pune

2.2.2 lëndë të parë dhe materiale konsumi.

2.3 PAGESA

2.3.1 Pagesa e subvencionit të përfituar për krijimin e vendeve të reja pune bëhet 50% (pesëdhjetë për qind) me miratimin e aplikimit por jo më shumë se 750.000 lekë dhe 50% (pesëdhjetë për qind) pas realizimit të shpenzimeve, kundrejt faturave të paraqitura, të cilat vërtetojnë shpenzimet e kryera, sipas dokumenteve në 3.3.1.

2.3.2 Një ndërmarrje sociale mund të përfitojë për hapjen e deri 20 (njëzet) vendeve të reja të punës.

3.SUBVENCION PËR SIGURIMET E DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE TË PUNONJËSVE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE, QË U PËRKASIN GRUPEVE TË PA FAVORIZUARA

3.1 KUSHTET QË DUHEN TË PLOTËSOHEN

3.1.1 Punësimin e personave nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara, kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se dy vjet.

3.2 KOSTOT E PRANUARA

Ndërmarrja sociale mund të përfitojë një financim vjetor në masën deri në 100% (njëqind për qind) të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit dhe punëmarrësit

3.2.1 Sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore

3.3 PAGESA

3.3.1 Financim 100% (njëqind për qind) bëhet drejtpërdrejt në degën e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse kundrejt vërtetimeve me lidhjen e kontratave të punës.

Sipas informacionit të paraqitur në tabelat e mësipërme, vërehet se:

- Vetëm për formën e subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë fondi përcakton nevojën për bashkëfinancim nga NS (30% të kostove të pranuar),
- Numri i punonjësve dhe vlera maksimale e subvencionit që mund të aplikojë dhe përfitojë një NS për formën e tretë të subvencionit që mbulon sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore nuk janë të përcaktuara.
- Një NS gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së saj, përfiton vetëm një herë subvencionin për zhvillimin e veprimtarisë, sipas pikës 11 të vendimit për krijimin e fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale[21], ndërkohë që për format e tjera duket se nuk ka një kufizim të tillë.
- Fondi i subvencionit për krijimin e vendeve të reja të punës për individët nga grupet e pafavorizuara, mund të përdoret për mjete pune, lëndë të parë dhe materiale konsumi për vendin e ri të punës, por jo për mbulimin e pagave të punonjësve të rinj. Ato organizata të cilat parashikojnë të krijojnë vende të reja pune për kategoritë e grupeve të pafavorizuara dhe duan të përfitojnë fonde për të mbuluar pagat e punonjësve (deri në 50% të pagës minimale), për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara, për një periudhë gjashtëmujore, duhet të aplikojnë për formën e subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale.

Një limit i cili ndikon në vlerën që ndërmarrjet sociale mund të përfitojnë nga fondi i NS lidhet me vlerën totale të mbështetjes nga buxheti i shtetit. Sipas përcaktimeve në VKM Nr.85, datë 25.6.2018 "Autorizim i Ndhmës Shtetërore për Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve Sociale"[22], vlera totale e ndihmës së dhënë për një ndërmarrje sociale, e siguruar sipas kësaj skeme dhe skemave të tjera të mbështetjes nga buxheti i shtetit (të gjitha format e mbështetjes nga buxheti i shtetit), nuk duhet të kalojë shumën 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë për një periudhë prej tre vjetësh.



[21] Vendim Nr.789, datë 26/12/2018 "Krijimin e Fondit të Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale"
<https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/192/fd987916-e4d4-4cb6-8f4c-1cacc488f742;q=%E2%80%9320VENDIM%20Nr.%20789,%20dat%C3%AB%2026.12.2018%20>

[22] <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/06/25/85>

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR FINANCIM PËR **NDËRMARRJET SOCIALE**

Në korrik të vitit 2021, pesë muaj para mbarimit të periudhës së fondit (2019-2021), NS-të janë njoftuar nga MSHMS për shpalljen e thirrjes për aplikim për financim të NS-ve. Më poshtë janë paraqitur hapat, kriteret, kushtet dhe dokumentacioni që duhen plotësuar nga OJF-të që kanë marrë statusin e NS për aplikim për financim, sipas Udhëzuesit Nr.376, datë 18.06.2020 "Për Kriteret e Dhënies dhe Mekanizmin e Monitorimit të Ndhmës Shtetërore të Ndërmarrjes Sociale"[23] dhe udhëzimit "Për Aplikime për Financimin e Subjekteve që kanë Marrë Statusin e Ndërmarrjeve Sociale"[24].



✓ **FORMA JURIDIKE E ORGANIZATËS**

Subjekti duhet të ketë marrë statusin e NS.

✓ **KRITERET E PËRSHTATSHMËRISË SË NS ME SKEMËN E NDIHMËS SHTETËRORE**

- Aftësi për financim 30% të kostove të projektit të propozuar, në fazën e aplikimit, për formën e subvencionit të zhvillimit të veprimtarisë;
- Në objektivin e veprimtarisë duhet të jetë një nga veprimtaritë që përfshihen në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 12.1.2018 "Për Miratimin e Listës së Veprimtarive që Ushtrojnë Ndërmarrjet Sociale"[25];

- Të punësojë minimalisht 3 punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pa favorizuara, brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit dhe kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se 2 vjet;
- Të ketë selinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

✓ **KËRKESË DREJTUAR MSHMS**

Fillimi i procedurës nga vetë NS me anë të një kërkesë drejtuar MSHMS sipas formatit të aplikimit[26] të miratuar nga kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.

✓ **PROJEKT PROPOZIM OSE PLAN BIZNESI**

NS-të së bashku me formularin e aplikimit duhet të paraqesin edhe një projekt propozim ose plan biznes, të shoqëruar me një relacion shpjegues mbi rëndësinë strategjike të projektit, si dhe përshkrimin e detajuar të elementëve të mëposhtëm:

- vlerën totale të parashikuar të subvencionit;
- kohën e nevojshme për realizimin e projektit;
- produktivitetin dhe vlerën e shtuar që do të sjellë ky projekt;
- mundësitë e punësimit dhe hapjen e vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e mbështetjes financiare;
- përputhshmërinë e projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;
- mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;
- mundësitë e zhvillimit dhe të përmirësimit të kushteve e standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;

[23] <http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/06/18/376>

[24] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[25] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/3/02fe6caf-962b-45b4-b467-b9683e2b6d84;q=VENDIM%20Nr.%2016,%20dat%C3%AB%2012.1.2018>

[26] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

- rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunitetit, si pasojë e realizimit të këtij investimi;
- vetë deklaram që ndërmarrja është e aftë për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara;

DOKUMENTACION QË DUHET PARAQITUR

- Urdhri i ministrit përgjegjës për miratimin e statusit të ndërmarrjes sociale të lëshuar, jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit
- Fotokopje të vendimit të regjistrimit në gjykatë dhe statuti i organizatës;
- Ekstrakti i gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Qarkut, Tiranë).
- Dëshmi nga gjykata që organizata nuk është në situatë të falimentimit, likuidimit, ndërprerjes së veprimtarisë ose marrëveshjes me donatorët/kreditorët ose ndonjë situatë të ngjashme që lind nga një procedurë e të njëjtit lloj ose që i nënshtrohen një procedure të të njëjtit lloj; (Online tek e-albania/tek Tatimet që kanë status aktiv);
- Formulari i plotësuar i aplikimit, i vulosur në çdo faqe dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i organizatës;
- Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);
- CV të organizatës (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së);
- Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti, dhe/ose Formularët e Deklarimeve dhe Pagesave për Personat Fizik;
- Vërtetim nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore (original ose me vulë digjitale (Online tek e-albania/tek Tatimet), për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

- Informacion mbi numrin e të punësuarve dhe nivelin e pagës së dhënë për çdo person, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për pagat në sektorin publik.[27]
- Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit të specifikuar për tre muajt e fundit;
- Një kopje të aktit të inspektimit në punë në rast se organizata ka ushtruar më parë aktivitetin e saj;
- Vërtetim bankar (ku pasqyrohen numri IBAN dhe numri i llogarisë së organizatës, në lekë) si dhe emrin/emrat e personave të autorizuar të kryejnë veprime bankare.
- Vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me 30% të buxhetit të plan biznesit, për formën e subvencionit “të zhvillimit të veprimtarisë”;
- Bilanci financiar i vitit të fundit (Online tek e-albania/tek Tatimet).

[27] Shënim i autorit: Nëpërmjet listpagesave, që deklaron financa cdo muaj në Tatime.

ANALIZË E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM PËR FINANÇIM

Thirrja për aplikim për financim është e publikuar në faqen e MSHMS, sikurse dhe formulari për aplikim[28], i cili duhet të plotësohet dhe firmoset në momentin e aplikimit për subvencionin. Mënyra e hedhjes së dokumentacionit lidhur me aplikimin për fondin, krijon vështirësi në identifikimin e formularit të aplikimit të duhur për thirrjen për financim pasi formulari nuk është i lidhur me thirrjen përkatëse, dhe nuk e ka të përcaktuar në titull se për cilin aplikim është. Formulari për aplikim është i njëjtë për të tre format e subvencionit, dhe një NS-të mund të aplikojë për të treja format e subvencionit njëkohësisht.

Si në faqen e MSHMS ku është publikuar thirrja për financim edhe vetë në thirrje mungon informacioni në lidhje me afatet kohore për periudhën e aplikimit. Thirrja vazhdon të jetë në faqen e MSHMS dhe për mungesë të afateve kohore të përcaktuar për aplikim duket sikur thirrja vazhdon të jetë e hapur, pavarësisht se thirrja është mbyllur dhe fondi ka qenë i vlefshëm vetëm për vitet 2019-2021.

Një informacion tjetër i munguar në thirrje lidhet me faktin nëse një NS mund të aplikojë vetëm për një nga format e subvencionit, më shumë se një, apo për të treja njëkohësisht. Ka vetëm një moment në thirrje (pika 2. Procedurat e aplikimit për marrjen e financimit të Ndërmarrjes Sociale), në të cilin thuhet se: “procedura e aplikimit për një nga format e mbështetjes të ndërmarrjeve sociale, iniciohet nga vetë organizata jofitimprurëse...”, e cila lë të kuptohet që një NS mund të aplikojë vetëm për një nga format, por nuk ka një referencë të qartë lidhur me këtë në asnjë nga dokumentet që lidhen me fondin. Ndërkohë, nga diskutimet me ministrinë është thënë që NS-të mund të aplikojnë për më shumë se një formë subvencionimi.

Informacioni në lidhje me fondin dhe format e financimit është i shpërndarë në tre dokumente të ndryshëm:

- VKM Nr.85, datë 25.6.2018 “Autorizim i Ndhmës Shtetërore për Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve Sociale”[29]
- VKM Nr.789, datë 26.12.2018 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale”[30]
- Udhëzim Nr.376, datë 18.06.2020 “Për Kriteret e Dhënies dhe Mekanizmin e Monitorimit të Ndhmës Shtetërore të Ndërmarrjes Sociale”[31]

Përveçse përsëritjes dhe mbivendosjes së informacionit në tre dokumentet e sipërpërmendur, në disa raste vërehet një lloj inkonsistence (p.sh. kërkimi i dokumenteve të ndryshëm për kritere të njëjta) e cila krijon konfuzion dhe vështirësi për NS-të të cilat duan të aplikojnë për financim.

Në pikën 12 të vendimit[32] për krijimin e fondit thuhet që: subvencione për krijimin e vendeve të reja të punës përfitojnë ato ndërmarrje sociale që paraqesin propozime, të cilat reflektojnë rritjen e numrit të të punësuarve me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara dhe kanë nevojë për fonde që mbulojnë pjesërisht kostot e krijimit të vendit të ri të punës. Por, sipas pikës 10 të po këtij vendimi (shkronja c), një ndër kushtet që duhet të plotësojë një NS për të përfituar subvencione për zhvillimin e veprimtarisë, është që të punësojë minimalisht 3 punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë. Pra, pavarësisht formës së subvencionit që kërkojnë, të gjitha NS-të duhet të shtojnë numrin e punonjësve të tyre, me të paktën 3 punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara.

Duke iu referuar kritereve ekonomike të përcaktuara nga MSHMS për marrjen e statusit

[28] <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>

[29] <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/06/25/85>

[30] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/192/fd987916-e4d4-4cb6-8f4c-1cacc488f742;q=%E2%80%93%20VENDIM%20Nr.%20789,%20dat%C3%AB%2026.12.2018%20>

[31] <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/06/18/376>

[32] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/192/fd987916-e4d4-4cb6-8f4c-1cacc488f742;q=%E2%80%93%20VENDIM%20Nr.%20789,%20dat%C3%AB%2026.12.2018%20>

të NS, ndër të cilat përfshihet edhe përfshirja e të paktën 3 punonjësve me kohë të plotë (ku ndër ta 30% duhet ti përkasin grupeve të pa favorizuara), ky kusht i vendosur për përfitimin e fondit, e rrit numrin e punonjësve të NS në një nivel që vlerësohet i lartë në krahasim me nevojën për burime njerëzore në bazë të veprimtarive të tyre. Gjithashtu, është e vështirë për ndërmarrjet sociale të vazhdojnë të mbajnë të punësuar punonjësit, pas përfundimit të mbështetjes financiare nga fondi dhe përfundimit të veprimtarive, aktiviteteve dhe projekteve specifike për të cilat stafi është punësuar. Ky kusht është është vlerësuar nga NS-të si një ndër arsytet penguese që të aplikojnë për financim nga Fondi i Ndërmarrjeve Sociale.

Krahas kërkesës me shkrim dhe formularit të aplikimit, në udhëzim përcaktohen edhe dokumentet që ndërmarrjet sociale duhet të dorëzojnë gjatë aplikimit, disa prej të cilave paraqesin disa problematika si më poshtë:

Urdhri i ministrit përgjegjës për miratimin e statusit të ndërmarrjes sociale të lëshuar, jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit;

Nuk është e qartë se çfarë kuptohet me “të lëshuar jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit”. Urdhri i statusit të ndërmarrjes sociale lëshohet vetëm një herë nga MSHMS (njohja e statusit bëhet me vendim të ministrit), pasi bëhet vlerësimi i aplikimit dhe verifikohet që janë përmbushur kërkesat ligjore. Është e pamundur që ky urdhër të jetë lëshuar jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit për financim, veçanërisht për ato organizata që e kanë marrë statusin në 2019 dhe 2020, në rastin konkret. Në fakt, kërkesa e një dokumenti të tillë duket e tepërt, pasi MSHMS është institucioni që e lëshon këtë dokument dhe administron regjistrin e ndërmarrjeve sociale me të gjitha të dhënat e tyre. Kërkesa e këtij dokumenti

argumentohet nga MSHMS me faktin që procesi vlerësohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, si dhe mund të ketë ndërmarrje sociale që e kanë ndërprerë aktivitetin, për të cilat MSHMS nuk ka të dhëna (në mungesë të udhëzimit “Procedurat dhe Dokumentacioni i Nevojshëm për Ndalimin e Veprimtarisë së një Ndërmarrje Sociale dhe Heqja e Statusit të Ndërmarrjes Sociale”).

Dëshmi nga gjykata që Organizata nuk është në situatë falimentimi, likuidimi, përfundim aktiviteti, janë në gjendje të falimentimit, likuidimit, ndërprerjes së veprimtarisë, falimentimit ose marrëveshjes me donatorët/kreditorët ose ndonjë situatë të ngjashme që lind nga një procedurë e të njëjtit lloj ose që i nënshtrohen një procedure të të njëjtit lloj; (Online tek e-albania/tek Tatimet që kanë status aktiv);

Kërkesa është shprehur në mënyrë jo të qartë, ka përsëritje dhe i referohet dokumenteve nga dy institucione të ndryshme. Dokumenti i parë që kërkohet “dëshmi që organizata nuk është në situatë falimentimi, likuidimi, ndërprerje veprimtarie”, nuk është një dëshmi por vërtetim që organizata nuk është në situatë falimentimi, likuidimi dhe sigurohet në gjykatë. Ndërkohë që në kundërshtim me atë që specifikohet në udhëzim, gjykata nuk ofron vërtetim për ndërprerjen e veprimtarisë, apo të marrëveshjes me donatorët. Dokumenti i dytë është vërtetim për statusin e organizatës (aktiv, pasiv), i cili sigurohet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës/aplikimit pranë portalit shtetëror e-albania.

Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);

Në këtë rast, nuk specifikohet se në çfarë forme kërkohet dokumenti (kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin / kopje e panjësuar me origjinalin, etj.). Ky specifikim duhet të bëhet në përputhje me Udhëzimin “Për kriteret e dhënies dhe mekanizmin e monitorimit të ndihmës shtetërore të ndërmarrjeve sociale”[33], i cili në pikën 10: Procedurat për aplikim (10.2.) specifikon që “dokumentet paraqiten në origjinal, kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin / kopje e panjësuar me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit”.

Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti, dhe/ose Formularët e Deklarimeve dhe Pagesave për Personat Fizik.

Pjesa e dytë e kërkesës “dhe/ose Formularët e Deklarimeve dhe Pagesave për Personat Fizik” nuk është e aplikueshme për organizatat jofitimprurëse, të cilat nuk e kanë detyrim ligjor dorëzimin e deklarimeve të tilla.

Vërtetim nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore (origjinal ose me vulë digjitale (Online tek e-albania/tek Tatimet), për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

Është e paqartë dhe e panevojshme shprehja “për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit”. Ky vërtetim merret online nga e-albania me vulë digjitale dhe konfirmon që subjekti ka ose nuk ka detyrime deri në datën e aplikimit për vërtetim.

Informacion mbi numrin e të punësuarve dhe nivelin e pagës së dhënë për çdo person, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për pagat në sektorin publik;

Kërkesa nuk është e shprehur në formën e një dokumenti. Kërkohet informacion, por jo dokumenti që ofron këtë informacion dhe institucioni që e lëshon atë.

Një kopje të aktit të inspektimit në punë në rast se organizata ka ushtruar më parë aktivitetin e saj;

Kjo nuk përcaktohet nga OJF, prandaj ky dokument nuk mund të merret në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit.

Bilanci financiar i vitit të fundit (Online tek e-albania/tek Tatimet)

E paqartë kërkesa për këtë dokument, pasi është i njëjtë me “Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti”.

[33] <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/06/18/376>

APLIKIMI I FONDIT NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE PËR PERIUDHËN 2019-2021

Sipas informacionit të marrë nga MSHMS, ka pasur 4 (katër) aplikime për fondin në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, dhe asnjëra prej tyre nuk është financuar për periudhën 2019-2021. Më poshtë janë listuar disa nga arsyet e dhëna nga MSHMS për këtë proces/vendim.

Problematikat nga ana e ministrisë:

- Fondi për Ndërmarrjet Sociale miratohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe ka një afat përdorimi brenda një periudhe të caktuar kohore (në rastin konkret periudha 2019-2021). Sipas MSHMS, kjo mënyrë e menaxhimit të fondit e ka vështirësuar përdorimin të tij, pasi për shkak të problematikave gjatë procesit të aplikimit, nuk ka qenë e mundur që ministria të realizojë procesin brenda afateve kohore të fondit, e për rrjedhojë fondi nuk ka mundur të përdoret. Përfshirja e fondit në buxhetin e MSHMS, vlerësohet prej ministrisë si një mundësi për më shumë fleksibilitet dhe efikasitet në menaxhimin dhe përdorimin e tij.
- Gjatë periudhës 2019-2020, e cila përkon me situatën e emergjencës për shkak të pandemisë COVID-19, MSHMS, e ka vendosur fondin në dispozicion të situatës emergjente, duke e rikuperuar atë më vonë.
- Sipas MSHMS të gjitha organizatat që kanë aplikuar, kanë pasur mungesa në dokumentacionin e paraqitur, të cilat kanë sjellë mos kualifikimin e tyre për përfitimin e fondit. Disa nga problemet kryesore gjatë aplikimit lidhen me buxhetin dhe planin e biznesit të NS, i cili sipas ministrisë nuk ka arritur të tregojë që siguron qëndrueshmëri dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Një tjetër dokument i munguar ka qenë akti i inspektimit në punë, për shkak të mungesës së inspektimit nga ana e inspektorëve përkatës.

Problematikat nga ana e NS-ve:

Organizatave me status të NS-së, i vlerësojnë këto skema financiare të ofruara nga MSHMS si të dobishme për arsye të mbështetjes me mjete financiare që janë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Por, pavarësisht vlerësimit dhe avantazheve që mund të përfitonin gjysma e organizatave me status të NS nuk ka aplikuar për financim nga fondi i ndërmarrjes sociale. Arsye për këtë vendim të NS-ve janë:

- periudha e shkurtër kohore për aplikim për financim;
- vështirësitë në plotësimin e dokumentacionit të duhur;
- kufizimet dhe vështirësitë në plotësimin e kriterëve për aplikim për financim;
- numri i lartë i personave që duhet të punësojnë nga grupet e pa favorizuara; si dhe
- limitet në shumën dhe numrin e përfitimeve nga fondi për NS.

REKOMANDIME

Bazuar në analizën më sipër, ky dokument ofron disa rekomandime të cilat adresojnë problematikat në lidhje me statusin dhe fondin e NS-ve, për ndërhyrje të mëtejshme, në mënyrë që të krijohet një mjedis mbështetës për zhvillimin e sipërmarrjeve dhe ndërmarrjeve sociale në Shqipëri.

Rekomandime që lidhen me Statusin e Ndërmarrjes Sociale

Problematikat e identifikuar gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të ligjit për ndërmarrjet sociale, janë reflektuar në praktikë duke sjellë vështirësi të ndryshme në zbatimin e tij si nga institucionet ligj zbatuese (në rastin konkret MSHMS) dhe nga organizatat jofitimprurëse, si subjekte të tij. Si rrjedhojë, kërkohet një rishikim i plotë i ligjit dhe gjithë paketës ligjore në zbatim të tij, e të adresohen këto problematika, si më poshtë:

Rekomandimi 1:

Rishikimi i paketës ligjore dhe rregullatore për ndërmarrjet sociale, që të reflektojnë qëllimin e ligjit për ndërmarrjet sociale, i cili është: “mbrojtja dhe përfshirja sociale e grupeve vulnerabël,..”, dhe jo nxjerrja nga skema e papunësisë e personave të papunë. Punësimi dhe integrimi i personave nga grupet e pa favorizuara dhe ofrimi i shërbimeve për individët me nevoja të veçanta (dy komponentë të ligjit), duhet të kenë të njëjtën vlerë në aplikimet për marrjen e statusit dhe përfitimin e mbështetjes nga skemat e financimit të ndërmarrjeve sociale. Në të kundërt, duhet të rishikohet kuadri ligjor, duke ndarë dy forma të ndërmarrjeve sociale: ato që ofrojnë shërbime dhe ato të cilat ofrojnë integrim dhe punësim për personat nga grupet e pa favorizuara.

Rekomandimi 2:

Përcaktimi në Ligjin 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” i kriterëve për përfitimin ose marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale. Praktika tregon që kriteret për mbajtjen e statusit të ndërmarrjes sociale të përcaktuara në ligj, nuk mund të jenë të zbatueshme edhe për marrjen e statusit. Aplikimi i të njëjtave kriterë nga ana e MSHMS ka rezultuar në tërheqjen e OJF-ve nga iniciativa për marrjen e statusit të NS, sepse e kanë të pamundur përmbushjen e tyre, veçanërisht përfshirjen e të paktën 3 (tre) personave me pagesë, apo realizimin e të ardhurave nga aktiviteti ekonomik në % e përcaktuara në ligj për mbajtjen e statusit. Reflektimi i duhur i kriterëve të përcaktuara në ligj për përfitimin e statusit si dhe rishikimi dhe përdorimi i terminologjisë së duhur në Udhëzuesin “Thirrje për Aplikim për Regjistrim dhe Marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale”2019.

Rekomandimi 3:

Plotësimi i paketës ligjore me aktin nënligjor që rregullon përfundimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale. Prezenca e këtij akti do të krijonte qartësi për mënyrën se si rregullohen ndërmarrjet sociale në rast të ndërprerjes së veprimtarisë e tyre, duke përcaktuar masat e ndërmarrja kundrejt tyre si dhe çfarë ndodh me organizatat pas humbjes së statusit.

Rekomandimi 4:

Rishikimi i listës së kategorive të personave të grupeve të pa favorizuara dhe shoqërimi i saj me një listë të dokumenteve që vërtetojnë përkatësinë e individëve në kategoritë e grupeve të pa favorizuara, si dhe institucioni përgjegjës për lëshimin e dokumenteve respektivë.

Rekomandimi 5:

Komunikimi dhe konsultimi me të gjithë aktorët e përfshirë në proces për çdo ndryshim apo interpretim gjatë zbatimit të ligjit në mënyrë që këto ndryshime të reflektojnë realitetin dhe të shmangen problemet që mund të lindin më vonë gjatë zbatimit në praktikë.

Rekomandime që lidhen me Fondin e Ndërmarrjeve Sociale

Problematikat që kanë shoqëruar procesin e aplikimit për të përfituar financim nga Fondi i Ndërmarrjeve Sociale si dhe paqartësitë në dokumentacionin e ofruar në lidhje me këtë proces, kanë sjell shumë vështirësi dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në mbylljen jo të suksesshme të këtij procesi duke mos u financuar asnjë nga ndërmarrjet sociale. Për këtë arsye është e nevojshme të rishikohen dokumentet përkatëse dhe të adresohen problematikat si më poshtë:

Rekomandimi 6:

Rishikimi i thirrjes “Për Aplikime për Financimin e Subjekteve që kanë marrë Statusin e Ndërmarrjeve Sociale ” dhe përfshirja në udhëzim në mënyrë të detajuar të informacioneve në lidhje me fondin e ndërmarrjeve sociale, format e subvencionit, limitet në shumën e financimit, limitet në numrin e aplikimeve për të përfituar financim, afatet kohorë të kohëzgjatjes së aplikimit, dhe bashkëngjitja formatit të aplikimit në thirrje. Krijimi i formularëve të ndryshëm aplikimi të përshtatur sipas kriterëve për secilën formë të subvencionit, si dhe të specifikohet qartë për sa forma subvencioni mund të aplikojnë NS-të në një thirrje. Procesi i aplikimit për financim në praktikë ka treguar që mungesa e këtyre informacioneve ka limituar numrin e ndërmarrjeve sociale në aplikimin për financim nga Fondi i NS-ve.

Rekomandimi 7:

Rishikimi i kriterëve për format e subvencionit, kriterëve për limitet në vlerën e fondit, si dhe kriteret në lidhje me mënyrën e përdorimit të fondit. Përdorimi i subvencionit për krijimin e vendeve të reja të punës për mbulimin e pagave të punonjësve nga grupet e pa favorizuara ka më shumë kuptim sesa përdorimi i subvencionit për mjete pune. Do të ishte më e arsyeshme që kostot e pranuar për pagesën e punonjësve në subvencionin për zhvillimin e veprimtarisë të përdorej për subvencionin për krijimin e vendeve të reja të punës dhe kostot e pranuar për mjete pune në subvencionin për krijimin e vendeve të reja të punës të përdoren në subvencionin për zhvillimin e veprimtarisë. Unifikimi i informacionit dhe dokumentacionit për Fondin e Ndërmarrjes Sociale në një dokument të vetëm.

Rekomandim 8:

Rishikimi i listës së dokumenteve dhe adresimi i problematikave të identifikuar më sipër. Shpjegimi në mënyrë të qartë dhe të saktë të dokumenteve që kërkohen si dhe përcaktimi i institucioneve pranë të cilave mund të sigurohen këto dokumente.

Rekomandim 9:

Pasqyrimi i informacionit dhe procesit të aplikimit online, njoftimi dhe konsultimi me grupet e interesuara për të gjitha ndryshimet që rekomandohen për procesin e aplikimit për financim nga Fondi i NS.

Rekomandime të Përgjithshme

Rekomandim 10:

Përdorimi në mënyrë aktive dhe efektive i seksionit të ndërmarrjes sociale në faqen e MSHMS. Paraqitja dhe publikimi i thirrjeve, njoftimeve, paketës ligjore, informacione të përditësuara dhe zhvillimet më të fundit në lidhje me ndërmarrjet sociale me qëllim informimin e ekosistemit. Krijimi i një seksioni pyetje përgjigje në faqen e MSHMS, ku shpjegohet dhe u jepet përgjigje disa nga vështirësive që kanë hasur OJF-të gjatë aplikimit, në mënyrë që të shërbejnë si pikë referimi për OJF-të që do aplikojnë dhe kanë të njëjtat pyetje dhe vështirësi.

Rekomandim 11:

Krijimi i një platforme online (portal) për procesin e aplikimit për përfitimin e statusit dhe për aplikimin për financim nga Fondi i Ndërmarrjes Sociale. Nëpërmjet portalit, organizatat do kenë mundësinë që gjithë procesin e aplikimit si dhe gjithë dokumentacionin ta dorëzojnë online. Krijimi i platformës do të unifikonte procesin dhe do e lehtësonte aplikimin për organizatat aplikuese.

Rekomandim 12:

Zhvillimi në mënyrë periodike i takimeve shpjeguese me organizata të interesuara për marrjen e statusit dhe financim nga Fondi i Ndërmarrjeve Sociale në lidhje me procedurat që duhen ndjekur dhe dokumentacioni që duhet dorëzuar për përfitimin e tyre. Ofrimi i më shumë informacioneve, seminareve, programeve të trajnimit dhe mentorimit për organizatat që synojnë të iniciojnë një ndërmarrje sociale.





SHTOJCA

SHTOJCA 1. AKTET NËNLIGJORE NË FUNKSION TË LIGJIT NR. 65/2016 "PËR NDËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI"

Lista e plotë e Akteve Nënligjore të nxjerra në funksion të ligjit nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri" janë si më poshtë:

VENDIM Nr.716, datë 1.12.2017 -
Për Përcaktimin e Procedurave të
Kryerjes së Kontrollit të
Veprimtarisë së Ndërmarrjes
Sociale

VENDIM Nr.16, datë 12.01.2018 -
Për Miratimin e Listës së
Veprimtarive që Ushtrajnë
Ndërmarrjet Sociale

VENDIM Nr.56, datë 31.01.2018 -
Për Përcaktimin e Kategorive
Konkrete të Grupeve të Pa
favorizuara

VENDIM Nr.85, datë 25.6.2018 -
Autorizim i Ndhmës Shtetërore për
Krijimin e Fondit të Ndërmarrjeve
Sociale

UDHËZIM Nr.602, datë 01.08.2018 -
Për Procedurat dhe
Dokumentacionin e Nevojshëm për
Marrjen e Statusit të Ndërmarrjes
Sociale

URDHËR Nr.636, datë 03.09.2018 -
Për Miratimin e Rregullores Tip të
Funksionimit të Ndërmarrjeve
Sociale

UDHËZIM Nr.677, datë 27.09.2018 -
Përcaktimi i Formave, Afateve dhe
Mënyrave të Raportimit Periodik,
për Veprimtaritë e Ushtruara dhe
Kategoritë e Personave të Punësuar
nga Ndërmarrjet Sociale

VENDIM Nr.789, Datë 26.12.2018 -
Krijimin e Fondit në Mbështetje të
Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e
Mbështetjes Nëpërmjet
Subvencionit për Ndërmarrjet
Sociale

UDHËZIM Nr.02, datë 04.01.2019 -
Krijimi i Regjistrit të Ndërmarrjeve
Sociale dhe Rregullat për Mbajtjen e
tij

UDHËZIM Nr.376, datë 18.06.2020 -
Për Kriteret e Dhënies dhe
Mekanizmin e Monitorimit të
Ndihmës Shtetërore të Ndërmarrjes
Sociale

UDHËZIMI NUK KA DAL -
Procedurat dhe Dokumentacioni i
Nevojshëm për Ndalimin e
Veprimtarisë së një Ndërmarrje
Sociale dhe Heqja e Statusit të
Ndërmarrjes Sociale

DOKUMENT POLITIKASH

KONTAKT

**PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM
DHE ZHVILLIM**

**RRUGA E ELBASANIT, PARK GATE
BUILDING, KATI 10-TË,
AP. 71 / 73, KUTIA POSTARE 2418/1,
1010 TIRANË, SHQIPËRI**

**www.partnersalbania.org
partners@partnersalbania.org**

2022